


# Hartimi i materialeve mësimore ndërvepruese

Dr. Gerda SULA, Dr. Edlira Kola

## WORD CLOUD

Listoni tri fjalë që ju vijnë në mendje kur lexoni termin *“materiale mësimore digjitale”*?

Jepni përgjigjen tuaj në:

https://www.menti.com/js3p5m2hyq

## Qëllimi i përgjithshëm:

Aftësimi i pjesëmarrësve në hartimin e një materiali mësimor digjital cilësor dhe efektiv, mbështetur në një strukturë të propozuar.

## Përse ky webinar?

*kornizë e ngushtë dhe e ngurtë fizike*

*proces mësimor statik dhe i njëkahshëm mësues-nxënës*

*uniformitet dhe shabllone*

*kontekst më i gjerë e fluid, fizik e virtual*

*proces mësimor shumëvektorial, ndërveprues, me në qendër nxënësin*

*punë e pavarur, mendim kritik, kreativitet, sens praktik, individualitetit*



# 1. PËRSHTATJA E MATERIALEVE MËSIMORE ME OBJEKTIVAT MËSIMORË/REZULTATET E TË NXËNIT DHE PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES MËSIMORE

# Kritere të hartimit të objektivave mësimorë/rezultateve të të nxënit



**Kriter për hartimin e materialeve mësimore digjitale:**

Përshtatja me synimet e lëndës, si dhe me objektivat/rezultatet e të nxënit apo rezultatet mësimore.

***Supozojmë:***

*Një mësuesi sapo i është caktuar zhvillimi i një lënde. Ai është njohur me temat dhe çështjet e tani planifikon të hartojë materialet mësimore për to.*

*Ç'hapa duhet të ndjekë?*

## Kritere të hartimit të objektivave mësimorë/rezultateve të të nxënit

**Diskutim:**

Nga e filloni / do ta fillonit ju punën për shtjellimin e një prej çështjeve të një teme mësimore,

a. nga përpilimi i objektivave mësimorë/rezultateve të të nxënit apo
b. nga përcaktimi i përmbajtjes mësimore të çështjes? Përse?

Vendosni përgjigjen tuaj në chat box.



# Kritere të hartimit të objektivave mësimorë/rezultateve të të nxënit






# Si përcaktohet përmbajtja mësimore e një çështjeje?




***Këshillë praktike:*** *Ndani çështjet në nënçështje, për një organizim më të përshtatshëm të materialit për version digjital.*



# 2. BURIMET E MATERIALEVE MËSIMORE

## Burimet kryesore të materialeve mësimore digjitale dhe besueshmëria e tyre

### Kategoritë e burimeve të materialeve mësimore



*1.Burime të shkruara (të printuara ose online):* tekste mësimore, monografi, artikuj, enciklopedi, gazeta, raporte etj.



*2. Burime audio, vizuale dhe audio-vizuale:* regjistrime zanore (leksione, referime, etj.), foto, skema, diagrame, video shpjeguese, dokumentarë etj.

## Burimet kryesore të materialeve mësimore digjitale dhe besueshmëria e tyre

*A është ky burim serioz dhe i besueshëm për t’u shfrytëzuar për përgatitjen e materialit tim mësimor?*



**Burimet e printuara**: materiale të standardizuara, të certifikuara.



**Burimet online:** sasi e madhe informacioni, materiale të pafiltruar – sfidë më e madhe.

## Burimet kryesore të materialeve mësimore digjitale dhe besueshmëria e tyre

*Si  të sigurohemi që një burim është i besueshëm?*





**Diskutim:**

Klikoni në dy website-t e mëposhtme.

website 1: [https://www.northwestern.edu/searle/resources/teaching-strategies-materials.html](https://www.northwestern.edu/searle/resources/teaching-strategies-materials.html)

website 2: [https://mednat.news/](https://mednat.news/)

Jepni vlerësimin tuaj se cilin do të merrnit në konsideratë si burim informacioni për përgatitjen e materialeve mësimore dhe cilin jo. Përse?

Vendosni përgjigjen tuaj në chat box.



# 3. HARTIMI/PËRSHTATJA E MATERIALIT NARRATIV: SI TA BËJMË MË INTERAKTIV?

# Kriteret për materialet mësimore për të qenë efektive edhe në version digjital




Materiali narrativ

## Gjatë punës me materialin narrativ:

- ✓ Shkruani në mënyrë të thjeshtë e me fjali të shkurtra.
- ✓ Ndërthureni tekstin me pyetje.
- ✓ Përdorni metafora për të shpjeguar koncepte/procese të ndërlikuara.
- ✓ Mbështetuni në situata të përditshmërisë.



- ✓ **Rregulla e artë:** Jo mbi 5-6 minuta lexim për një material narrativ të pandërprerë.

***SFIDA: Pasurimi i materialit narrativ me elemente interaktive.***

## Vlefshmëria e përdorimit të mjeteve ilustruese

**Diskutim:**

Sipas jush, përse në përgatitjen e materialeve mësimore digjitale ngulet këmbë në përfshirjen e mjeteve ilustruese dhe në përdorimin e mediave ndërvepruese?

Vendosni përgjigjen tuaj në chat box.



# Vlefshmëria e përdorimit të mjeteve ilustruese dhe mediave ndërvepruese



## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# VIDEOT

**Avantazhet e përdorimit:**

❖Zëvendësojnë tekstet e gjata.

❖Kanë funksion konkretizues.

❖Tërheqin vëmendjen edhe të nxënësve më pak të interesuar.

❖Ideale në lëndë/tema praktike

**Si t'i sigurojmë:**

❖ Të gatshme në internet, duke:

- në versionin origjinal të tyre,
- duke i modifikuar/përshtatur, (shkurtim, vendosje skripti, voice over etj.)

❖ Të krijuara vetë.

**Kohëzgjatja:**

Videot hyrëse (ngacmuese, motivuese ) – më të shkurtra

Videot shpjeguese – më të gjata

**Rregulla e artë:** jo mbi 5-6 minuta.

## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# VIDEOT

**Burime videosh në internet:**

| | |
|---|---|
| Edpuzzle | www.edpuzzle.com (falas) |
| Clipchamp | https://clipchamp.com/en/ (ka një version falas) |
| Adobe Spark | https://spark.adobe.com/about/video (falas) |
| Animaker | https://goo.gl/TS2r6F (ka një version falas) |
| Animatron Studio | https://www.animatron.com/studio (ka një version falas) |
| OFFEO | https://offeo.com/?ref=polymath (falas) |
| Renderforest | http://bit.ly/2SngQIt (falas) |

## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# FOTOT

**Avantazhet e përdorimit:**

- ❖Mënyrë e shpejtë, efektive e përcjelljes së një ideje, mesazhi.
- ❖Pikënisje për një diskutim/debat.
- ❖Thyese të monotonisë së tekstit narrativ.

**Burime fotosh në internet:**

Pexels https://www.pexels.com (falas)

Freepik https://www.freepik.com/ (falas)

Unsplash https://unsplash.com/ (falas)

LibreStock https://librestock.com/ (falas)



# Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

## ORGANIZUESIT GRAFIKË

**Avantazhet e përdorimit:**

- Organizojnë informacion, koncepte apo ide në mënyrë skematike.
- Ndihmojnë në strukturimin e ideve.
- Shpjegojnë raporte varësie, lidhje shkak-pasojë etj.
- Shërbejnë si mjet orientues për shkrimin e raporteve, eseve.

**Burime organizuesish grafikë në internet:**

Canva www.canva.com (falas)

EdrawMax www.edrawmax.com

Mind Meister www.mindmeister.com

## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# ORGANIZUESIT GRAFIKË

Hartë mendore



## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# ORGANIZUESIT GRAFIKË

Diagrami i Venit



## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# ORGANIZUESIT GRAFIKË

Grafiku (diagrami) i rrjedhës



## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# ORGANIZUESIT GRAFIKË

## Grafiku i linjës së kohës (Timeline)



## Lloje të mjeteve ilustruese dhe burimet e tyre

# ORGANIZUESIT GRAFIKË

## Grafiku KWL




K – çfarë di
W – çfarë dua të di
L – çfarë mësova



# 4. PËRPILIMI I SKRIPTIT TË MATERIALIT MËSIMOR DIGJITAL

## Përpilimi i skriptit të materialit mësimor digjital

**Diskutim:**

Si mendoni, ku qëndron rëndësia e ndjekjes së një strukture të caktuar gjatë punës për hartimin e materiali mësimor digjital?

Vendosni përgjigjen tuaj në chat box.



## Skema MAIPA dhe avantazhet e aplikimit të saj

**M** Mirëseardhja

**A** Aktivizimi i njohurive ekzistuese

**I** Informimi

**P** Përpunimi dhe transferimi

**A** Analiza

- Model i provuar didaktik.
- Strukturon procesin për hartuesin (*Ku ta vendos? Si ta ndërthur? Ku rrezikoj monotoni?*).
- Ndihmon nxënësin që të orientohet.



Fleksibilitet



Rrjedhshmëri dhe koherencë



Interaktivitet dhe atraktivitet

## Si ta aplikojmë MAIPA-n në skriptin e materialit mësimor digjital?

# Mirëseardhja



- Kontakti i parë me materialin.
- Akullthyes: hyrje e butë në procesin e të nxënit.
- Motivon, ngacmon, nxit shprehjen e mendimit të lirë etj.

**Ç'mund të përdorim?**

- Imazh/video e shkurtër
- Citat i lidhur me njohuritë e reja
- Sondazh
- Histori e shkurtër/situatë përditshmërie

# Aktivizimi i njohurive ekzistuese



- Ndihmon për të kuptuar nëse njohuritë e përcjella janë solide.
- Krijon një kalim gradual nga informacioni ekzistues në atë të ri.

**Ç'mund të përdorim?**

- Set pyetjesh
- Diskutim
- Organizues grafik
- Imazh/video për interpretim
- Tabelë interaktive
- Detyrë e shkurtër
- Minitest
- Stuhi mendimesh

Si ta aplikojmë MAIPA-n në skriptin e materialit mësimor digjital?

# Informimi & Përpunimi dhe transferimi



- Ecin bashkë në këtë strukturë.
- Përfaqësojnë “trupin“ e materialit mësimor.

**Ç’mund të përdorim?**

- Tekst narrativ + imazhe, pyetje, diskutime etj.
- Në fund, një detyrë.

# Analiza



Ndihmon për të kuptuar:

- nëse objektivat mësimorë janë përmbushur;
- nëse qasja ishte e suksesshme.

**Ç'mund të përdorim?**

- Pyetje sintetizuese, deduktuese
- Diskutim
- Hartë mendore
- Tabelë interaktive
- Dilemë
- Rast studimi



# 5. PËRCAKTIMI DHE HARTIMI I INSTRUMENTEVE TË VLERËSIMIT

## Përcaktimi dhe hartimi i instrumenteve të vlerësimit

**Diskutim:**

A duhet të kenë disa specifika instrumentet e vlerësimit kur bëhet fjalë për materiale mësimore digjitale? Përse?

Vendosni përgjigjen tuaj në chat box.



## Përcaktimi dhe hartimi i instrumenteve të vlerësimit

*Ç'kritere duhet të përmbushin instrumentet e vlerësimit në materialin mësimor digjital?*

- në përputhje me objektivat mësimorë;
- të larmishme;
- interaktive;
- të pranishme gjatë gjithë materialit mësimor digjital / procesit të të nxënit;
- të mundësojnë të gjitha format e vlerësimit (mes shokëve, vetëvlerësim).

✓Efektivitet

✓Atraktivitet

✓Aktivizim të vazhdueshëm

✓Ndërgjegjësim mbi nevojat për përmirësim

## Përcaktimi dhe hartimi i instrumenteve të vlerësimit

*Cilat janë disa nga avantazhet e procesit të vlerësimit digjital?*



✓ Fleksibilitet kohor dhe hapësinor.



✓ Feedback i menjëhershëm/i shpejtë.



✓ Mundësi për nxënësin për të ritestuar/rivlerësuar veten.

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për format digjital

### *USHTRIMET ME ALTERNATIVA*

- Përshtaten si për pyetje të thjeshta, edhe për më të elaboruara.
- Probabilitet i ulët për hamendësim të përgjigjes së saktë.

- Bazohen më shumë te dallimi i alternativës së saktë, jo te njohja e saj.

**Si t'i bëjmë më efektive?**

- Mos vendosni alternativa që janë dukshëm të gabuara, që përgjigja e saktë të mos jepet vetëm duke eliminuar ato.
- Shoqërojeni përgjigjen e gabuar me një shpjegim (për t'u shfaqur pas klikimit).

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për format digjital

### *PLOTËSO VENDET BOSH*

- Janë të thjeshta për t'u krijuar.
- Favorizojnë njohjen, jo thjesht dallimin mes alternativave të gabuarve.

- Janë të përshtatshme vetëm për përgjigje të shkurtra (një fjalë në vendin bosh.
- Në rast se fjala nuk shkruhet saktë, përgjigjia nuk është e vlefshme.

**Si t'i bëjmë më efektive?**

- Kufizojeni përdorimin për terma kyçë, të rëndësishëm për t'u mbajtur mend.
- Në platformë, shtoni opsione duke hamendësuar gabimet e mundshme në përgjigjen e saktë (psh. Tirana, tirana; klientelë, klientele)

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për format digjital

### *E VËRTETË / E GABUAR*

| | |
|---|---|
| ○ Janë më të thjeshtat për t'u krijuar. | ○ Gjetje me anë të hamendësimit (50%) |

### Si t'i bëjmë më efektive?

○ Përdoreni veçanërisht për situata që kanë dy opsione të mundshme (psh. rritet / ulet, gjithëvjetor / sezonal etj.).

○ Shoqërojeni përgjigjen e gabuar me një shpjegim (për t'u shfaqur pas klikimit).

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për format digjital

### *LIDHJE ELEMENTESH (MATCHING)*

○ Përfshijnë informacion të gjerë mbi çështjen e dhënë.

○ Probabilitet i ulët për hamendësim të përgjigjes së saktë.

○ Bazohen më shumë te dallimi i alternativës së saktë, jo te njohja e saj.

### **Si t'i bëjmë më efektive?**

○ Përdoreni për elemente ku lidhja është e qartë dhe nuk lë vend për interpretime (psh. n njërin krah mjeti, në krahun tjetër funksioni)

○ Shoqërojeni përgjigjen e gabuar me një shpjegim (për t'u shfaqur pas klikimit).

# Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për një format digjital

## *DRAG AND DROP*

- Janë të përshtatshme për futur në vlerësim situata reale, praktike.
- Mund të realizohen me ikona/imazhe, duke u bërë edhe më tërheqëse.

- Bazohen më shumë te dallimi i alternativës së saktë, jo te njohja e saj.

### Si t’i bëjmë më efektive?

- Përdoreni veçanërisht për situata që kanë dy opsione të mundshme (psh. rritet / ulet, gjithëvjetor / sezonal etj.).
- Shoqërojeni përgjigjen e gabuar me një shpjegim (për t’u shfaqur pas klikimit).

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për një format digjital

### *PYETJET E HAPURA*

| | |
|---|---|
| ○ Nxitin mendimin e strukturuar dhe frymën analitke. | ○ Marrin më shumë kohë për t’u përgjigjur. |
| ○ Nxitin mendimin kritik dhe krijimtarinë. | ○ Rrezikojnë dalje nga tema, tejzgjatje. |
| ○ Janë të përshtatshme për të realizuar vlerësim mes të ngjashmëve. | ○ Janë më të vështira për t’u vlerësuar. |

**Si t’i bëjmë më efektive?**

○ Jepini karakter interaktiv, duke përdorur media si Padlet, Mentimeter apo të ngjashme.

○ Përdorini si instrument vlerësimi mes të ngjashëmve.

## Disa tipe instrumentesh vlerësimi të përshtatshme për një format digjital

### *DETYRA / PUNË NË GRUP*

○ Stimulojnë kreativitetin.

○ Ushqejnë aftësi të buta (fryma e të punuarit në skuadër, komunikimi, respektimi i roleve).

○ Mund të lënë nxënësit pasivë më në hije.

○ Janë më të vështira për t'u vlerësuar.

**Si t'i bëjmë më efektive?**

○ Përdorini për të matur aftësitë e nxënësve në çështje si: zgjidhja e problemeve, përshkrimi I hapave të punës etj.

○ Për t'i bërë interaktive, përdorni mediat e sugjeruara më sipër, si Padlet, Mentimeter etj.

○ Përdorini si instrument vlerësimi mes të ngjashëmve.

*Ju faleminderit!*